



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 121 - Korrik 2013 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Pamje nga fushata e korrije shirjeve në Malishevë



Klubi I notit "Besa", pas suksesit
në kampionatin shtetëror



Përmbajtja:

Përfundoi seanca e XLI e KK të Malishevës	3
U formua Shtabi për korrije shirje në Malishevë	4
Kryetari Kilaj , priti Zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme	4
Kryetari priti palët	5
Administrata do të punojë edhe me orar të zgjatur në shërbim të mërgimtarëve	5
KKSB: Situata e sigurisë e qetë dhe stabile në Malishevë	6
Dhjetëra rrugë duke u shtruar nëpër fshatrat e Malishevës	7
Rendimente jo të kënaqshme nga korrja e grurit	8
Një kompani italiane e interesuar për luftimin e rriqrave	10
Malisheva mbështet festivalin 911 (Nine Eleven)	11
“Caritas-i” zviceran mbështet arsimin parashkollorë në Malishevë	11
MKRS ndihmon me tituj të librave bibliotekën komunale në Malishevë	12
Kryetari priti palët	13
KN “Besa” nga Banja më e suksesshmja në kampionatin e notit	13
Kryetari Kilaj dhe “Miqte e Amerikës” fillojnë iniciativën për shpalljen “Qytetar Nderi” i Malishevës për ambasadorin Christopher Hill	14
Ethet hemorragjike, vazhdojnë të jenë shqetësimi kryesor	15
Kryetari shtroi iftar për familjarët e dëshmorëve	16
Ndihmohen 14 persona me aftësi të kufizuara	17

Përfundoi seanca e XLI e KK të Malishevës

Malishevë, 1 korrik



Mbledhja e XLI (katërdhjetënjë-t) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Malishevës, e drejtuar nga kryesuesi i saj, z.Ragip Begaj, ka përfunduar sot, me njoftim e kuvendit për Planifikimin e zyrës së Prokurimit për vitin fiskal 2013, përderisa në fund të seancës, kryesuesi Begaj, bëri të ditur se seanca e ardhshme do të mbahet në fund të muajit gusht, për shkak të pushimeve verore.

Për planifikimin e zyrës së prokurimit, për vitin fiskal 2013, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, i ka njoftuar menaxheri i Zyrës së Prokurimit, z.Elmi Paçarizi, i cili bëri të ditur se “planifikimi nga kjo zyrë, bëhet në harmoni me buxhetin komunal të miratuar nga KK dhe me prioritetet e Kryetarit të Komunës, për investimet kapitale”. Paçarizi, bëri të ditur se deri më tani është realizuar gati nëntëdhjetë për qind e planifikimit. Ai më pas është përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të KK të Malishevës, si dhe ka dhënë sqarimet për paqartësitë eventuale.

Në pikën e fundit të rendit të ditës (të ndryshme) më mesin e disa çështjeve të ngritura, kryesuesi Ragip Begaj, i njoftoi anëtarët e KK të Malishevës, se mbledhja e ardhshme do të mbahet nga fundi i muajit gusht, për shkak të pushimeve verore.

U formua Shtabi për korrje shirje në Malishevë

Malishevë, 2 korrik

Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Malishevë , ka formuar Shtabin Komunal për korrje shirje në përbërje prej pesë anëtarësh dhe i cili do të drejtohet nga Milaim Morina dhe në përbërje të të cilit do të jenë të përfshira Drejtoria për Bujqësi, Inspektoriat, Emergjencia , dhe Shoqata e fermerëve të kësaj komune.

Sipas Drejtorisë për BPZHR , fushata e korrje shirjeve në Malishevë pritet të filloj me datën 5 korrik 2013 përderisa bëhet e ditur se në Komunën e Malishevës janë të mbjella me grurë mbi 3500 hektarë , ndërsa pritet të angazhohen 38 autokombajna që gravitojnë në Komunën e Malishevës si dhe rreth 20 autokombajna të regjioneve tjera.

Çmimi për korrje shirje për hektar është 110 euro pa lidhje të kashtës, ndërsa me lidhje të kashtës 130 euro, çmim ky i caktuar nga Ministria për Bujqësi në nivel vendi.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi i kësaj komune z. Sinan Kryeziu ndërkaq ka thënë se rendimentet sivjet priten të jenë mesatare përderisa ka bërë të ditur se në disa fshatra të Komunës së Malishevës ka pas edhe rënie të grurit nga të reshurat atmosferike si në Vermicë, Drenoc dhe në disa fshatra komunës sonë.

Kryetari Kilaj , priti Zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme

Malishevë, 3 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës z. Kilaj , priti sot Zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Ismet Ibishin, ku qëllimi i vizitës ishte njoftimi mbi sistemin epidemiologjike në Komunën e Malishevës të shkaktuar nga ethet hemorragjike.

Me këtë rast zëvendësministri Ibishi shprehu keqardhjen e thellë me të cilën po ballafaqohet Komuna e Malishevës duke ofruar me këtë rast përkrahjen e plotë për luftimin e kësaj sëmundje nga ana e MPB.



Kryetari Kilaj dhe zëvendësministri Ibishi me këtë rast biseduan edhe mundësinë që gjatë vitit të ardhshëm dezinfektimi të bëhet jo vetëm me pompa dore, por në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe spërkatja për dezinfektimin e rriqrave të bëhet në mënyrë ajrore.

Kryetari falënderoi Zëvendësministrin e MPB-së z.Ibishin për vizitën dhe interesimin rreth kësaj situate që po vazhdon ta përcjell Komunën e Malishevës, dhe njoftoi për masat dhe hapat që janë marrë deri më tani për luftimin e etheve hemorragjike, ndërsa projekti për të cilin u fol pritet të realizohet në vitin e ardhshme pasi që tani veç është faza përfundimtare e atakimit nga rriqrat për këtë vit.

Kryetari priti palët

Malishevë, 4 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, edhe sot si çdo të enjte hapi dyert për qytetarët që në orët e hershme të mëngjesit, për t'i dëgjuar dhe mbështetur, rreth problemeve dhe halleve me të cilat ballafaqohen ata ç'do ditë.

Edhe sot shqetësimet e qytetarëve ishin kryesisht të njëjtat si çështja socio-ekonomike, infrastruktura rrugore dhe ankesa tjera nga më të ndryshmet që qytetarët e Komunës së Malishevës i parashtruan para kreut të Komunës.

Kryetari Kilaj edhe me këtë rast ka ofruar mbështetjen e tij të plotë morale si dhe mbështetjen e mundshme materiale gjithmonë duke pas parasysh mundësitë e komunës sonë.

Kryetari Kilaj edhe me këtë rast qytetarëve u ofroj mbështetjen e institucionit të kryetarit dhe u premtoj atyre ndihmën në ballafaqimet me problemet dhe shqetësimet të cilat i shprehën para tij në takimet e sotme.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Administrata do të punojë edhe me orar të zgjatur në shërbim të mërgimtarëve

Malishevë, 8 korrik



Qeveria komunale e Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të saj, të drejtuar nga Kryetari i Komunës z.Isni Kilaj, ku janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me punët e përditshme të qeverisë komunale, si dhe për çështje të tjera aktuale, siç është fushata e korrje shirjeve, situata endemike nga ethet hemorragjike dhe çështje të tjera.

Drejtori i drejtorisë së Administratës, z.Haki Krasniqi, njoftoi se kërkesat për dokumentacion në shërbimin e ofiqarisë, janë shtuar dukshëm. Sipas Krasniqit, “varësisht prej nevojave, do rritet edhe orari i punës për shërbimin e ofiqarisë dhe në asnjë mënyrë qytetarët nuk do të presin për marrjen e dokumenteve të kërkuara, në veçanti mërgimtarët, kur tash pritet edhe shtimi i numrit të mërgimtarëve që vijnë në pushime”.

Drejtori për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Sinan Kryeziu tha “ janë shpërndarë 40-të krerë lopë qumështore në posedim të personave që janë të interesuar për të prodhuar për treg” dhe në mes tjerash njoftoi edhe për fushatën e korrje shirjeve, që ka filluar dhe po vazhdon mbarë. Sipas drejtorit Kryeziu, rendimentet mesatare janë të kënaqshme, ndërsa nuk janë regjistruar probleme, përjashtuar disa dëme të cilat janë shkaktuar nga breshëri që kanë rënë të dielën, në disa vendbanime të Malishevës.

Sa përket situatës me ethet hemorragjike, ka njoftuar drejtori për shëndetësi, z.Skënder Hoti. Sipas tij, “në Klinikën Infektive të QKUK-së, kemi të shtrirë dy persona dhe gjendja e tyre është stabile”. “Dymbëdhjetë persona janë regjistruar të infektuar me rriqrat, ndërsa deri më sot numri i të thumbuarve nga rriqrat është 1741 persona, që janë paraqitur në emergjencën e QKMF-së në Malishevë, përderisa fushata e spërkatjes së zonave endemike, po vazhdon ende”,

KKSB: Situata e sigorisë e qetë dhe stabile në Malishevë

Malishevë, 11 korrik

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në takimin e rregullt të saj, të mbajtur sot, e ku marrin pjesë të gjitha strukturat lokale të sigorisë, si dhe shoqëria civile, e kanë vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigorisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Malishevës për dy muajt e kaluar (maj-qershor), dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situate.



Zëvendës komandanti i stacionit policor në Malishevë, togeri Istref Bytyçi, tha se “situata është e qetë e stabile dhe pa tendencë të prishjes së sigurisë së përgjithshme dhe e gjitha është në suaza të normales”. Ai po ashtu bëri me dije, se në “përgjithësi, ka rënë numri i veprave penale, pastaj aksidenteve në komunikacion, si dhe është rritur efikasiteti i policisë në Malishevë, në intervenime, zbulime dhe gjetjen e autorëve të cilët kryejnë vepra”.

Ndërsa shefi i drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ejup Zulfaj, bëri me dije se edhe situata e sigurisë në aspektin e emergjencave, është shumë e mirë, përderisa rastet e zjarreve janë shumë të pakta, e në këtë po ndikojnë edhe kushtet atmosferike.

Në këtë takim, u bë e ditur edhe për përgatitjet për sezonin e zjarreve, që eventualisht, mund të ketë gjatë ditëve të nxehta të verës. Sipas drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, përgatitjet janë bërë për këtë sezonë, si dhe është punuar shumë në sensibilizimin e opinionit, kundër zjarreve. Për këtë, edhe zyrtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), deklaruan se janë të përgatitur, por gjithmonë, duke bërë thirrje, që të bëhet kujdes i shtuar, në mënyrë që të mos shkaktohen zjarre.

Dhjetëra rrugë duke u shtruar nëpër fshatrat e Malishevës

Malishevë, 15 korrik



Në territorin e Komunës së Malishevës, aktualisht janë shtruar apo janë duke u shtruar dhjetëra rrugë, kryesisht në lagjet e fshatrave, të cilat i lidhin me rrugët kryesore. Shtrimi i këtyre rrugëve, është duke u bërë në kuadër të realizimit të prioritetëve të qeverisë komunale të Malishevës dhe të Kryetari të Komunës, z.Isni Kilaj, të planifikuara për këtë vit.

Ndërtimi i rrugëve nëpër lagjet e vendbanimeve në Komunën e Malishevës, është nevojë e kohës dhe në



kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimit të kushteve të jetës për banorët dhe rritjes së mirëqenies për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Po ashtu ndërtimi i rrugëve nëpër lagje, po realizohet, pasi paraprakisht janë shtruar rrugët kryesore që lidhin fshatrat me qendrën komunale dhe rrugët tjera, për gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës.

Momentalisht, është shtruar rruga në lagjen “Karaqica” në fshatin Balincë, me një gjatësi pres rreth 700 metrave, ndërsa asfaltimi i saj, i ka kushtuar buxhetit komunal, mbi 45 mijë euro. Rrugë tjetër, që është asfaltuar, është ajo e lagjes Morina, në fshatin Lumnishtë, e gjatë 450 metra dhe që ka kushtuar mbi 33 mijë euro.

Janë duke u rregulluar dhe shtruar edhe rrugët në fshatin Mirushë, e gjatë 680 metra, e cila kushton rreth 44 mijë euro, pastaj ajo e lagjes Shala në Banjë, tri lagje në Mleqan, rruga e një lagjeje në Drenoc, pastaj Golluboc, Garaqevë, Dragobil, Fshati i Ri dhe të tjera, të gjitha këto me një shumë prej afro 600 mijë euro, nga buxheti komunal.

Ndërsa pritet që brenda pak ditëve, të fillojnë asfaltimet edhe të rrugëve në Astrazup, Ngucat, Bardh, Lladroc, Llozicë, tri rrugë në Bubavec, Turjakë, Pagarushë dhe disa rrugë nëpër qytetin e Malishevës, dhe këto investime, do të bëhen në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe që kapin në shumë prej 865 mijë euro.

Fushata e korrje shirjeve në përfundim e sipër

Rendimente jo të kënaqshme nga korrja e grurit

Malishevë, 19 korrik

Fushata e korrje shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës, është në përfundim e sipër dhe gjatë kësaj fundjave, pritet të përfundoj kjo fushatë, përderisa rendimentet e grurit sillen nga 2800 deri në 3200 kilogram për një hektar, ndërsa cilësia e grurit është mesatare, thuhet në deklarinimin e drejtorisë komunale për bujqësi.



kanë ardhur nga komunat tjera.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, z.Sinan Kryeziu, “fushata e korrje shirjeve, duhet të përfundoj gjatë kësaj fundjave, ndërsa korrja e grurit ka filluar me 5 korrik dhe në këtë fushatë të korrje shirjeve kanë qenë të angazhuar 55 kombajna të evidentuara nga shtabi i korrje shirjeve në Malishevë”. Sipas shtabit të korrjeve shirjeve, nga 55 kombajna të angazhuara në këtë fushatë, 40 prej tyre janë kombajna të Malishevës, ndërsa 15 sosh, janë kombajna të cilat

Drejtori Kryeziu, tregon se “sipas shënimeve që kanë marrë nga shtabi i korrje shirjeve, nga 3800 hektarë të planifikuar, sipas shtabit të korrjeve shirjeve janë mbjellë rreth 330 hektar me grurë, ndërsa cilësia e grurit të korrur është mesatare, përderisa rendimentet janë jo të kënaqshme, pasi rendimentet sillen nga 2800 deri në 3200 kilogram për një hektar”.

“Rendimentet janë jo të kënaqshme dhe në këtë kanë ndikuar disa faktor, siç janë të reshurat e mëdha atmosferike gjatë muajve maj dhe qershor, pastaj në disa pjesë edhe breshëri, i cili ka dëmtuar në masë të madhe grurin. Një faktor tjetër shumë me rëndësi që ka ndikuar në uljen e rendimentit, është “qarkullimi bimor”, pasi ka vite që hektar të tërë mbillen vetëm me grurë dhe nuk bëhet “qarkullimi bimor”, për tu mbjellë një vit grurë dhe një vit një kulturë tjetër. Po ashtu, një faktor tjetër që ka ndikuar në rendimentin e grurit është tërshëra e egër”, tha për Zyrën për Informim Publik, drejtori i drejtorisë komunale për bujqësi, z.Sinan Kryeziu.

Megjithatë, e tëra fushata e korrje shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës, është zhvilluar pa probleme.

Një kompani italiane e interesuar për luftimin e rriqrave

Malishevë, 22 korrik



Kompania e njohur italiane, e cila merret me zhdukjen e insekteve “Col Service”, ka vizituar sot Malishevën, ku janë takuar me Kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe drejtorin e QMKF-së, dr.Besim Zogaj, me të cilët kanë biseduar për mundësinë e angazhimit të kësaj kompanie, në eliminimin e rriqrave, si masë parandaluese kundër infektimit me virusin e etheve hemorragjike “krime-kongo”.


Administratori i kësaj kompanie, z.Giuseppe Colazzo, ka thënë kompania që ai administron, është e njohur në fushën e eliminimit të insekteve, përfshirë edhe rriqrat, dhe është e interesuar seriozisht që të merret me këtë edhe në Kosovë, kryesisht në Malishevë.

Në takimin e sotëm (i dyti me radhë), ishin të pranishëm edhe ekspert të kësaj kompanie, të cilët merren me studimin e insekteve, në mënyrë që të bëhet një studim i detajuar lidhur me zhvillimin rriqrave, e që më pas të bëhet edhe projekti për mënyrën e eliminimit të tyre. Edhe kompania në fjalë është fitimprurëse, zyrtarët e saj, thanë se studimin, do ta bëjnë falas.

Me këtë rast, Komuna e Malishevës, i ka ofruar mbështetjen e plotë kësaj kompanie, për të gjitha çështjet me interes, pasi eliminimi i rriqrave, është në interesin tonë, në mënyrë, që të zvogëlohet mundësia e infektimit me ethe hemorragjike, pasi ky virus bartet nga rriqra tek njeriu dhe në disa raste, thumbimi i rriqrave është vdekjeprurës.

Malisheva mbështet festivalin 911 (Nine Eleven)

Malishevë, 22 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot në një takim, drejtuesit e OJQ “Nine Eleven”, të cilët tradicionalisht organizojnë festivalin e filmit “Nine Eleven”, me të cilët ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit, të kësaj ngjarje të madhe kulturore dhe artistike.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, Komuna e Malishevës, do ta mbështes këtë festival, me rreth tre mijë euro.

Festivali “Nine Eleven”, organizohet në shenjë falënderimi për popullin amerikan dhe solidarizim me viktimat e 11 shtatorit dhe këtë vit, ky festival është jubilar, pasi mbahet edicioni i dhjetë me radhë.

Festivali parashihet të mbahet nga data 7 deri më 11 shtator në Prishtinë, ku filmat e përzgjedhur duhet të jenë filma shqip, apo edhe filma të huaj me tematikë shqiptare.

“Caritas-i” zviceran mbështet arsimin parashkollorë në Malishevë

Malishevë, 23 korrik



Zyrtarët e zyrës së “Caritas-it “ zviceran, kanë qëndruar sot në Malishevë, ku janë takuar me zyrtarët e drejtorisë komunale për arsim dhe edukim, me të cilët kanë biseduar për projektin, programin e saj, për arsimin parashkollorë, ku këtë vit është planifikuar që në këtë program të përfshihet edhe Komuna e Malishevës.

z.Kreshnik Basha, zhef i zyrës së “Caritas”-it zviceran në Prizren dhe përgjegjësi i këtij projekti, z.Albert Bakalli, janë takuar me z.Remzi Buçaj, zyrtar në Drejtorinë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, duke e njoftuar me projektin e “Cartas”-it, për edukimin parashkollorë.

Sipas zyrtarëve të “Caritas”-it, në këtë projekt të tyre, në Malishevë, synohet të përkrahen katër klasë të arsimit parashkollorë, të cilat do të përkrahen, me inventarin e nevojshëm për zhvillimin e mësimit parashkollorë, si dhe trajnimet e vazhdueshme të zhvillimit profesional për edukatorët.

Nga ana tjetër, zyrtari Buçaj, e ka mirëpritur këtë iniciativë të “Caritas”-it zviceran dhe ka ofruar bashkëpunimin e drejtorisë për arsim dhe edukim.

MKRS ndihmon me tituj të librave bibliotekën komunale në Malishevë

Malishevë, 24 korrik

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS), ka ndihmuar Bibliotekën komunale të Malishevës, me tituj të librave, në vlerë prej dy mijë euro, duke e pasuruar kështu fondin e librave në bibliotekën qendrore të Malishevës, dhe në të njëjtën kohë, janë plotësuar deri në një masë edhe kërkesat e lexuesve.

Sipas përgjegjëses së bibliotekave në Malishevë, znj. Hana Bytyçi, “është dërguar një projekt në MKRS, për ta ndihmuar bibliotekën në Malishevë, pasi kërkesat e lexuesve janë të mëdha dhe kanë hasur në mirëkuptim në MKRS, pasi këta të fundit e kanë përkrahur këtë projekt”.

“Ky financim në shumën prej dy mijë euro, ka mundësuar sjelljen e 192 titujve të rinj, lektyrave shkollore për arsimin e mesëm dhe atë fillor, pastaj letërsi moderne shqipe dhe botërore”, ka thënë për Zyrën për Informim, përgjegjësjë e bibliotekave në Malishevë, znj.Hana Bytyçi.



Sipas saj, kjo ka qenë kërkesë dhe nevojë e lexuesve të shumtë, që ka biblioteka dhe në një masë, janë plotësuar nevojat e tyre, përderisa pritet që fondi i librave në bibliotekë të rritet ende në të ardhmen.

Kryetari priti palët

Malishevë , 25 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, edhe sot si çdo të enjte, ka pritur qytetarët në zyrën e tij, për ti dëgjuar për plot dy orë rresht hallet dhe problemet e tyre, duke i mbështetur dhe dhënë këshillat e nevojshme, lidhur me çështjet e caktuara, të cilat kanë të bëjnë me komunën.

Problemet që qytetarët që u shfaqën tek Kryetari Kilaj, vazhdojnë të jenë të njëjta, si janë çështjet socio-ekonomike, infrastruktura rrugore, dhe nevoja e kërkesa tjera nga më të ndryshmet, me të cilat përballen qytetarët e Komunës së Malishevës.

Qytetarët, kanë falënderuar kryetarin Kilaj, për përkrahjen morale dhe mbështetjen e vazhdueshme në zgjidhjen e problemeve që ata kanë, qoftë ato individuale apo të komunitetit, si për rastet sociale, ashtu edhe për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme në vendbanimet e komunës së Malishevës.

KN “Besa” nga Banja më e suksesshmja në kampionatin e notit

Malishevë, 26 korrik

Klubi i notit “Besa” nga Banja, krenaria e sportit të Malishevës, ka dalë më e suksesshmja në kampionatin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, të mbajtur më 24 dhe 25 korrik, duke fituar tri nga pesë kupat e këtij kampionati, ndërsa për këtë sukses të klubit, i ka uruar edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj.



Sipas kryetrajnerit të klubit “Besa”, Adrian Telakut, “ në kampionatin e Republikës së Kosovës në not, të mbajtur më 24-25 korrik, në pishinën “Denisi” në Lipjan, KN “Besa”, ka fituar kupat në tri grupmosha, nga pesë sa ishin gjithsej, në kategorinë e pionierëve, kadetëve dhe juniorëve”.

Në këto gara, është thyer edhe një rekord shtetëror në not nga notarët e klubit “Besa”, në stafetën 4x50.

Për këtë sukses, notarët e klubit “Besa” i ka pritur edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, i cili i ka uruar notarët për suksesin e treguar në kampionatin e notit të Republikës së Kosovës, duke ju uruar suksese në të ardhmen dhe vazhdimin e përkrahjes nga ana e institucionit të komunës.

Kryetari Kilaj dhe “Miq të Amerikës” fillojnë iniciativën për shpalljen “Qytetar Nderi” i Malishevës për ambasadorin Christopher Hill

Malishevë, 26 korrik



Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot themeluesin e shoqatës “Miq të Amerikës” (The friends of USA) z.Agim Rexhepi, me të cilin kanë biseduar dhe janë dakorduar për fillimin e procedurave për shpalljen “Qytetar Nderi” i Malishevës, ish ambasadorin Christopher Hill, për kontributin e dhënë për popullin e Kosovës.

Kilaj e Rexhepi, u dakorduan për fillimin e kësaj iniciative, duke e konsideruar si një akt shumë të qëlluar, pasi ish ambasadori Hill, si i dërguar special i presidentit të SHBA-ve, z.Bill Clinton, gjatë luftës ka dhënë një kontribut shumë të madh, dhe se Hill ka



qenë njëri ndër më të zëshmit në grupin e miqve, që kanë përkrahur kërkesat tona legjitime, deri në pavarësinë e vendit.

“Ne kemi lidhje të gjata me amerikanët, e në veçanti gjatë luftës së fundit, ku kontributi i amerikanëve ka qenë i madh”, tha kryetari Kilaj, duke i kujtuar edhe bisedimet që janë zhvilluar gjatë viteve 1998-1999, në Dragobil, ku qenë zyra e misionit diplomatik amerikan në Kosovë (KDOM), duke e cilësuar si “ambasada amerikane” dhe në vende tjera. Kilaj, më pas e quajti ambasadorin Hill si “promotor të lëvizjeve dhe të arriturve të vendit tonë, gjatë luftës dhe pas luftës, me investimet që kanë ardhur nga USAID-i”.

Lidhje tjetër e Kilajt, është fakti se kryetari Kilaj, është “Qytetar nder” i qytetit Little Rock, vendlindja e ish presidentit Bill Clinton.

Nga ana tjetër, promotori i shoqatës “Miq të Amerikës”, pasi e njoftoi kryetarin Kilaj, me aktivitetet e kësaj shoqate, po ashtu e quajti si një ngjarje të madhe këtë iniciativë”.

Rexhepi, po ashtu shfrytëzoi rastin për ta përgëzuar Komunën e Malishevës, për përkrahjen e festivalit “Nine Eleven”. “Ju përgëzoi për mbështetjen që ja keni ofruar festivalit, i cili ju dedikohet viktimave të 11 shtatorit”, tha Rexhepi, duke e vlerësuar lartë mbështetjen e një organizimi të tillë, për një ngjarje e cila i prek zemrat e amerikanëve.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Ethet hemorragjike, vazhdojnë të jenë shqetësimi kryesor

Malishevë, 29 korrik

Situata me ethe hemorragjike, vazhdon të mbetet shqetësimi kryesor për qytetarët dhe qeverinë komunale të Malishevës, për shkak të vazhdimit të vdekjeve nga ky virus. Edhe në mbledhjen e fundit të Këshillit të Drejtorëve, kjo situatë, ishte tema kryesore e kësaj mbledhje, pasi këtë fundjavë, u shënua edhe rasti i katërt i vdekjes nga ethet hemorragjike krime-kongo.

“Çështja e etheve hemorragjike, pas rastit të katërt të vdekjes në territorin e Malishevës, vazhdon të jetë shqetësimi kryesor për neve, pasi nuk kemi mundësi tjera që të veprojnë si komunë”, tha kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, i cili i shprehi ngushëllime familjes Krasniqi nga Astrazupi.

“Qeveria e Republikës së Kosovës, ka formuar një komitet ndërministror, për çështjen e etheve hemorragjike, ndërsa ne si komunë, planifikojmë që vitin e ardhshëm të përdorimin edhe mundësinë e spërkatjes nga ajri, kundër rriqrave, si një masë parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, pasi rriqrat janë bartësit e këtij virusi vdekjeprurës”, tha kryetari Kilaj, pasi sipas tij, “kjo situatë nuk është e lehtë për askënd”.

Në mbledhjen e sotme të rregullt të qeverisë komunale, janë diskutuar edhe çështje tjera me rëndësi, që kanë të bëjnë e punët dhe obligimet e përditshme të qeverisë komunale dhe në realizimin e projekteve kapitale për këtë vit.

Kryetari shtroi iftar për familjarët e dëshmorëve

Malishevë, 31 korrik



Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, mbrëmë ka organizuar një darkë-iftar për familjet e dëshmorëve, në muajin e shenjtë të ramazanit. Në këtë iftar, përveç familjarëve të dëshmorëve, kanë marrë pjesë edhe krerët e Bashkësisë Islame në Malishevë, pastaj mysafir nga Prishtina e Prizreni, si dhe mysafir nga Turqia.

“Këtë iftar e kemi organizuar, në kuadër të muajit të shenjtë të ramazanit dhe për ti respektuar më të shenjtin tanë, dëshmorët tanë, pasi falë sakrificës së tyre, ne sot mundemi të organizojmë këtë iftar dhe të gëzojmë lirinë”, tha mes tjerash kryetari Kilaj, në fjalën e rastit, duke i falënderuar të gjithë të pranishmit në këtë iftar tradicional.

“Falë gjakut të dëshmorëve, ne sot kemi mundësi të shijojmë bashkërisht këtë iftar”, tha kreu i Bashkësisë Islame në Malishevë, mulla Xhevat Kryeziu, i cili falënderoi kryetarin Kilaj dhe Komunën e Malishevës për këtë organizim.

Bashkësia Islame në Malishevë, me këtë rast, ka ndarë një mirënjohje për Kryetarin e Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e mirë me Bashkësinë Islame.

Pas ngrënies së iftarit, përfaqësuesit zyrtar (hoxhallarët) të Bashkësisë Islame në Malishevë dhe mysafirët e Bashkësisë Islame nga Prishtina e Prizreni, si dhe mysafirët nga Turqia, kanë kënduar pjesë të Kuranit.

Ndihmohen 14 persona me aftësi të kufizuara

Malishevë, 31 korrik



Shoqata Humanitare “Nëna Terezë”, me seli në Ängelholm të Suedisë dhe bamirësit Robert e Halim Hoti, nga Carralluka, në kuadër të aktiviteteve të tyre humanitare, sot kanë ndihmuar 14 persona me aftësi të kufizuara, anëtar të Qendrës së Rehabilitimit (Handikos) në Malishevë.

Me këtë rast, koordinatoja e Qendrës së Rehabilitimit në Malishevë, znj. Feride Hoxha, i

ka falënderuar humanistët e familjes Hoti dhe shoqatën “Nëna Terezë”, për këtë ndihmë të madhe për këta persona, të cilët trajtohen në këtë qendër rehabilituese. “Kjo ndihmë është shumë e mirëseardhur, pasi bëhet pikërisht në prag të festës së Bajramit”, tha znj. Hoxha.

Nga ana tjetër, Robert Hoti, tha se “këto mjete janë grumbulluar nga dy koncerte humanitare të organizuar nga shoqata “Nëna Terezë”, me seli në Ängelholm të Suedisë” dhe se këto aktivitete humanitare, nuk do të ndalen.



Ndërsa Halim Hoti, i cili, i ka ndihmuar edhe tre persona tjerë, nga buxheti familjar, tha se “është i interesuar që aktivitetin e tij human, ta bëjë kryesisht në Komunën e Malishevës”, edhe njihet si një familje që ka kontribuar shumë në ndërtimin e shtëpive për personat e pastrehë, në tërë territorin e Kosovës.

Në kuadër të kësaj ndihme, 14 persona janë ndihmuar me nga 50 euro, ndërsa tre persona të tjerë, janë ndihmuar me nga 100 euro, nga buxheti i familjes Hoti.